Objekti i Komisionit Hetimor, sipas vendimit, është "...të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat përbëjnë shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra ..." (pika 2 e vendimit nr.135, datë 25.10.2007). Vendimi i Kuvendit është marrë mbi bazën e kërkesës së 28 deputetëve, të datës 15.10.2007, për nisjen e procedurës së hetimit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Kuvendi, me vendimin nr.141, datë 5.11.2007, miratoi raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor "Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm", ngritur me vendimin nr.135, datë 25.10.2007. Në raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor propozohet shkarkimi nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Theodhori Sollaku.

2. Kërkuari, Prokurori i Përgjithshëm, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kuvendit duke pretenduar se Komisioni Hetimor është i ngritur për të njëjtin objekt e me të njëjtin qëllim si vendimi i Kuvendit nr.31/2006, për të cilin Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur me vendimin nr.26/2006. Pretendimi kryesor i kërkuarit lidhet me rivlerësimin e punës së organit të Prokurorisë nga Komisioni Hetimor duke çmuar vendimet e prokurorëve, gjë e cila, sipas kërkuarit, nga vendimi i mësipërm i Gjykatës është gjetur në kundërshtim me Kushtetutën. Kërkuari pretendon gjithashtu, se Kuvendi dhe Komisioni

Hetimor nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Sipas kërkesit, me vendimin e kundërshtuar të Kuvendit të Shqipërisë është krijuar një konflikt me Prokurorinë, sepse në këtë rast, ligjvënësi ka marrë atribut që u përket organeve të tjera kushtetuese dhe konkretisht, prokurorisë dhe gjykatës.

Përfaqësuesi i kërkesit, në seancën gjyqësore, nuk hoqi dorë nga kërkesa e paraqitur Gjykatës Kushtetuese, por as nuk u shpreh për të, duke ia lënë në çmim Gjykatës Kushtetuese.

II

1. Përpara shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të kërkesit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon të domosdoshme të analizojë dhe t'u japë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga subjekti i interesuar lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave.

2. Në bazë të nenit 131/ç të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të vendosë për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, me kusht, që mosmarrëveshja të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre (neni 54/1 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”). Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto mosmarrëveshje kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete (neni 54/2 i ligjit të sipërcituar), dhe si bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve mund të shërbejë çdo lloj akti ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve, që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (neni 54/4 i ligjit).

3. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, si një ndër drejtimitet e drejtësisë kushtetuese, në jurisprudencën e kësaj Gjykate është trajtuar në disa vendime. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin e saj se dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organeve të subjektsh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej këtyre pushteteve (Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.26/2006, nr.29/2006, nr.20/2007). Gjykata ripohon qëndrimin e saj se, që të lindë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë këto kushte të nevojshme: mosmarrëveshja, si rregull, të lindë ndërmjet organeve që u përket pushteteve të ndryshme; mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përket; mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.26/2006). Çdo organ juridiksional, qoftë si institucion, si organ pushteti në kuptimin klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh.

4. Në rastin në shqyrtim janë të pranishëm të gjithë elementet e një mosmarrëveshje të tillë. Konkretisht, Kuvendi, si pushtet ligjvënës, ka marrë vendimin nr.135, datë 25.10.2007, me të cilin ka konsideruar veten kompetent për të kontrolluar e vlerësuar vendimet e organit të Prokurorisë për çështje konkrete. Organi i Prokurorisë ka pretenduar, se kjo është sferë e kompetencave të tij dhe ka kërkuar zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje në Gjykatën Kushtetuese. Lidhur me sferën e kompetencave të organit të Prokurorisë, Gjykata është shprehur se ato kanë të bëjnë me ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq, si dhe me kryerjen e detyrave të tjera të caktuara me ligj (neni 148/1 i Kushtetutës). Kështu, përveç ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në emër të shtetit, organi i prokurorisë, në linjë hierarkie, ka në kompetencë edhe kryerjen e kontrollit mbi vendimet e prokurorëve më të ulët (neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale; vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.26/2006).

5. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se Prokurori i Përgjithshëm legjitimohet si kërkuar në një mosmarrëveshje kompetencash (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.26/2006). Në një mosmarrëveshje të tillë, kërkesa, ngrihet nga subjektet në konflikt. Në rastin në shqyrtim, subjekt në konflikt është organi i Prokurorisë, përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili në emër të këtij organi ka pretenduar cenimin e kompetencave të tij. Kjo për faktin, se Prokuroria është organizuar si strukturë e centralizuar ku Prokurori i Përgjithshëm është përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit dhe për realizimin e detyrave të tjera që me ligj i ngarkohen Prokurorisë (neni 8 i ligjit të sipërcituar).

III

1. Kërkesit pretendojnë se Kuvendi ka shkelur parimin *ne bis in idem*. Vendimi nr.135, datë 25.10.2007 i Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”- sipas tij- vjen si përsëritje e vendimit nr.31, datë 2.5.2006, i cili është vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën nga Gjykata

Kushtetuese me vendimin nr.26, datë 4.12.2006.

Përfaqësuesi i Kuvendit e kundërshtoi këtë pretendimin duke parashtruar se objektet e vendimeve të Kuvendit nr.31/2006 dhe nr.135/2007 nuk janë të njëjta. Ato përmbajnë fakte dhe shkaqe ligjore të ndryshme.

2. Lidhur me parimin ne *bis in idem*, Gjykata vëren se neni 4 i ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” mbi parimet e përgjithshme parashikon se komisionet hetimore ngrihen dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve Kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj. Rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP) për hetimin, zbatohen drejtpërdrejt nga komisionet hetimore të Kuvendit. Një nga parimet në fjalë është ne *bis in idem*, i cili do të thotë literalisht “jo dy herë për të njëjtën” dhe që kuptohet se asnjë veprim ligjor nuk mund të fillohet dy herë për të njëjtin shkak. Parimi rrjedh nga e drejta romake, por është veçanërisht i zbatueshëm në çështjet penale dhe përfshihet edhe nga Kushtetuta (neni 34) dhe KPP (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5/2005).

3. Kërkuesi nuk parashtron në kërkesën e tij argumente se përse cenimi i parimit ne *bis in idem* përbën një shkak që lidhet me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues, që është zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave. Për këtë arsye Gjykata nuk e çmon të nevojshme të analizojë në mënyrë të hollësishme pretendimin për shkeljen e këtij parimi nëpërmjet ngritjes së Komisionit Hetimor me vendimin nr.135, datë 25.10.2007 dhe miratimit të raportit të këtij Komisioni, me vendimin nr.141, datë 5.11.2007 “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”.

IV

1. Sipas kërkuesit, me vendimin e kundërshtuar të Kuvendit të Shqipërisë, është krijuar një konflikt me organin e Prokurorisë, sepse në këtë rast, ligjvënësi ka marrë atributë që u përkasin organeve të tjera kushtetuese dhe konkretisht, prokurorisë dhe gjykatës. Për të shqyrtuar këtë pretendim, Gjykata duhet të mbajë parasysh funksionin kushtetues të Kuvendit (nëpërmjet komisioneve hetimore të tij), pozicionin kushtetues të Prokurorisë në strukturën e organeve të shtetit, në mënyrë të veçantë, kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Prokurorisë.

2. Gjykata, në shqyrtimin e funksionit kushtetues të Kuvendit dhe rolin e komisionit parlamentar hetimor në këtë drejtim merr parasysh faktin se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Demokracia kushtetuese e vendosur me këtë Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është njëri nga organet e autoritetit të shtetit. Kompetencat e tij – dhe për pasojë sfera e veprimtarisë së tij – është përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Kuvendi gëzon, brenda limiteve të parashikuara në Kushtetutë, një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Brenda kësaj sfere, shkalla e autonomisë së Kuvendit është më e madhe se në sfera të tjera të kompetencave të tij, për shkak të faktit, se ai, është organi ligjvënës i shtetit. Kushtetuta e ngarkon Kuvendin dhe me funksion kontrollues me synimin për të realizuar balancën midis pushteteve. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007). Në këtë kuptim, funksioni i kontrollit parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit ligjvënës për t’u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta. Kjo vlen edhe për komisionet hetimore, objekti i veprimtarisë të të cilëve, i përcaktuar në vendimet e ngritjes së tyre, është objekti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

3. Komisionet hetimore, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për kryerjen e kontrollit kryesisht mbi ekzekutivin, si dhe për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen në përfundime të caktuara (vendimi nr.18/2003 i Gjykatës Kushtetuese). Për të ngritur një komision hetimor nuk mjafton emërtimi i ndonjë komisioni parlamentar si “Komision Hetimor”. Komisioni i ngritur nga Kuvendi duhet të respektojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës, të cilët përcaktojnë parakushtet normative, si dhe sferën e veprimtarisë së një komisioni hetimor në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës.

Kur Kuvendi ngre një komision hetimor, duhet të respektojë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Për pasojë, detyra që i ngarkohet një komisioni hetimor parlamentar nuk mund të jetë e tillë që do të çonte në shkeljen e rregullimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organet, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit që ushtron Kuvendi. Kufijtë e veprimtarisë së një komisioni

hetimor janë specifikuar nga limitet kushtetuese për kontrollin e Kuvendit. Veprimtaria e një komisioni hetimor nuk duhet as të zëvendësojë e as të marrë kompetencat e organeve, të cilat, në bazë të Kushtetutës, janë të detyruara ta realizojnë këtë kompetencë. Gjykata është shprehur se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, si parimi i ndarjes së pushteteve, i prezumimit të pafajësisë etj. (Vendimi nr.18/2003 dhe vendimi nr.26/2006 i Gjykatës Kushtetuese). Një hetim i inicuar që nuk lidhet me qëllimet dhe që nuk i përket veprimtarisë së ligjvënësit dhe rolit kontrollues brenda kufijve të trajtuar më sipër, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese. Komisioni hetimor, duke hetuar një fushë të caktuar brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna, të cilat përbëjnë shkak për t'u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e organeve hetimore e gjyqësore të ngarkuara nga Kushtetuta për veprimtari të këtij lloji (18/2003).

Gjykata rithekson rëndësinë themelore që ka për rregullshmërinë në ngritjen e një komisioni hetimor, përcaktimi i “çështjes/ve” që do të jenë objekt i hetimit në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës. Përcaktimi i ekzistencës së një çështjeje që kërkon verifikim dhe vlerësim, si parakusht për ngritjen e një komisioni, duhet të kryhet në një mënyrë objektive. Objekti i hetimit, i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në kërkesë, duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose kompleks faktesh, të cilat të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit evidenton dhe çështjen e veçantë. Të gjitha ato çështje që përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që përmbajnë në vetvete një interes publik e përfshijnë këtë kuptim (Vendimi nr.18/2003 i Gjykatës Kushtetuese). Identifikimi i subjekteve dhe objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit është një kërkesë *sine qua non* për të përcaktuar saktësisht çështjet që duhet të adresojë komisioni, ose për të vlerësuar nëse duhet të ndërmerret ose jo një hetim për këtë çështje. “Çështja e veçantë” në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës përbëhet nga një sërë rrethanash, të cilat përcaktojnë objektin e interesit të Kuvendit. Këto rrethana duhet të specifikohen në vendimin e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor duhet të jetë i përcaktuar, i specifikuar dhe i kuptueshëm për të gjitha subjektet e mundshme, të detyruara të paraqiten përpara komisionit, ose të cilat detyrohen të paraqesin dokumentet e informacionet përkatëse të kërkuara nga komisioni. Vetëm atëherë është i mundur përcaktimi në mënyrën e duhur, i situatës së një çështjeje të caktuar, e cila, nga ana e saj, përbën një kërkesë për përmbushjen korrekte të një detyre që i është ngarkuar komisionit. Komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt çështja e veçantë dhe jo për të parë nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen (Vendimi nr.20/2007 i Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata është shprehur se Kuvendi mund të ushtrojë hetim nëpërmjet komisioneve të tij edhe mbi zyrtarët e institucioneve kushtetuese për çështje të veçanta, të cilat përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që lejohen nga Kushtetuta, por një hetim i tillë, nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20/2007).

4. Gjykata analizon edhe pozicionin kushtetues të organit të Prokurorisë në strukturën institucionale shtetërore, si dhe kompetencat kushtetuese e ligjore të këtij organi. Në këtë drejtim, u mbajt parasysh kuptimi kushtetues që i është dhënë pozitës dhe statusit të Prokurorisë në jurisprudencën e kësaj Gjykate.

Gjykata, me vendimin nr.26/2006, përveç të tjerave, është shprehur për disa veçori që ka organi i Prokurorisë, të cilat janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligj. Ky organ ka një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera, dhe veçanërisht si: a) organi i vetëm në vend që ushtron ndjekjen penale; b) organ që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që disponon mbi çështjet që ndodhen në gjykim dhe i lirë në kërkimet për llojin dhe masën e dënimit ndaj personave që i rezultojnë fajtorë; c) organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, gjë që do të thotë, që fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve dhe dërgimi në gjyq, janë attribute të prokurorisë; ç) organ i centralizuar, që vepron sipas rregullit, që urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët, ndërsa ligjshmëria e vendimeve dhe e veprimeve, si dhe rregullshmëria dhe plotësia e hetimeve të kryera nga prokurorët më të ulët kontrollohen vetëm nga prokurori më i lartë (neni 24/4/5 i ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar), me përjashtim të rasteve kur ligji procedural ia njeh gjykatës një të drejtë të tillë.

Funksioni i organit të Prokurorisë, si përfaqësues i akuzës në emër të shtetit (neni 148/1 i Kushtetutës), bën që ky organ të ketë të drejtën ekskluzive për të vendosur ose jo ndjekjen penale, d.m.th., nëse do të çojë ose jo një çështje në gjyq, nëse do ta pushojë ose jo një çështje në fazën e gjykimit. Kuvendi apo komisionet e tij hetimore, nuk kanë pushtetin e rishikimit të vendimit të marrë nga prokuroria, apo ta shtrëngojnë prokurorinë për të ndryshuar vendimet e saj. Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese vlerëson

gjithashtu, se mjetet e kontrollit parlamentar mbi Prokurorinë nuk mund të përdoren asnjëherë si instrument për të shqyrtuar dhe vlerësuar vendimet e marra nga ana e prokurorëve për çështje konkrete.

Gjykata e çmon të nevojshme të rritjes, se Prokurori i Përgjithshëm, si drejtues i organit të prokurorisë në kuptimin kushtetues, nuk ka përgjegjësi politike para Kuvendit. Një zgjidhje e tillë kushtetuese, ka për qëllim krijimin e një organi prokurorie që bazohet në profesionalizëm. Prokurori i Përgjithshëm është drejtues profesional e jo politik i Prokurorisë, karakteristika këto, që sigurojnë pavarësinë profesionale të këtij organi (Vendimi nr.26/2006 i Gjykatës Kushtetuese).

5. Gjykata në vlerësimin e çështjes mban parasysh lidhjen kushtetuese që ekziston midis institucioneve të Kuvendit dhe Prokurorisë. Kjo lidhje kushtetuese shprehet në faktin, se Prokurori i Përgjithshëm, për sa e lejon ligji, është i detyruar të japë shpjegime dhe të informojë në komisionet parlamentare për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tij (neni 80/3 i Kushtetutës), si dhe të informojë herë pas here Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit (neni 149/4 i Kushtetutës). Veç kësaj, Kuvendi jep pëlqimin për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm (neni 149/1 i Kushtetutës), si dhe i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e tij (neni 149/2 i Kushtetutës). Gjykata e çmon të nevojshme të rritjes, se në aspektin kushtetues, fakti se Kuvendi jep pëlqimin për emërimin, apo propozon shkarkimin e këtij funksionari publik nuk do të thotë që ky person është drejtpërdrejt përgjegjës ndaj Kuvendit. Edhe detyrimi për të informuar Kuvendin, nuk do të thotë se pavarësia e drejtuesit apo ajo e institucionit të drejtuar prej tij është e kufizuar (Vendimi nr.26/2006 i Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese vlerëson, se edhe rasti i paraqitur, duhet të shqyrtohet në këndvështrimin e konsideratave të mësipërme.

6. Në çështjen në shqyrtim, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, kanë kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor për nisjen e procedurave për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Në kërkesën e tyre, grupi i deputetëve ka parashtruar si shkaqe për ngritjen e komisionit dhe si aspekte që do t'i nënshtroheshin kontrollit parlamentar, një sërë çështjesh, të cilat do të vlerësohen më poshtë.

Kuvendi i Shqipërisë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e mësipërme, paraqitur nga grupi i deputetëve, duke e konsideruar atë të drejtë, me vendimin 135, datë 25.10.2007, vendosi të miratojë raportin përkatës të Komisionit për Çështjet Ligjore, si dhe të ngrejë komisionin hetimor për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Në pikën II të këtij vendimi është përcaktuar se Komisioni Hetimor ka për objekt dhe detyrë të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat përbëjnë shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me nenin 149 pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenin 7/2 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

7. Në pikën II të vendimit të sipërpërmendur, objekt hetimi do të jenë të dhëna, fakte dhe rrethana për veprime e mosveprime të Prokurorit të Përgjithshëm, por nuk është treguar, se cilat janë konkretisht të dhënat e faktet, që do t'i nënshtrohen verifikimit. Gjykata e çmon të nevojshme të rritjes se mosplotësimi i kërkesave të analizuara më sipër nga Gjykata lidhur me përcaktimin e "çështjes së veçantë" objekt i hetimit, krijon dyshime për përmbushjen në mënyrë të rregullt të detyrës që i ngarkohet komisionit.

Në kushtet e kësaj paqartësie të krijuar nga vendimi nr.135 i Kuvendit, siç është shprehur kjo Gjykatë dhe me vendimin nr.26/2006, objekti i hetimit të komisionit nuk mund të kuptohet i shkëputur nga çështjet që kanë gjetur pasqyrim në kërkesën e grupit të deputetëve dhe raportin e komisionit hetimor. Të dhënat, faktet dhe rrethanat që disponon Kuvendi janë ato që përmbledhen në kërkesën e grupit të deputetëve, që më pas, janë reflektuar edhe në raportin e hartuar nga Komisioni Hetimor në mbështetje të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002, i miratuar me vendimin 141, datë 5.11.2007 të Kuvendit të Shqipërisë.

Në kërkesën e tij, grupi i deputetëve ka parashtruar si shkaqe për ngritjen e komisionit dhe si aspekte që do t'i nënshtroheshin kontrollit parlamentar, një sërë çështjesh. Sipas tyre, Prokurori i Përgjithshëm ka shkelur rëndë ligjin organik dhe atë procedural penal në të paktën këto raste: - Në trajtimin e papërgjegjshëm të kallëzimeve penale të depozituara; - Në trajtimin e papërgjegjshëm të çështjeve të pushuara nga gjykata për mungesë provash; - Në trajtimin e papërgjegjshëm të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja; - Në trajtimin e papërgjegjshëm të rasteve flagrante të korrupsionit të kallëzuara nga institucionet e tjera publike.

8. Gjykata, duke ballafaquar çështjet objekt hetimi parlamentar me standardet kushtetuese të parashtruara më sipër dhe që kanë të bëjnë me funksionet e komisioneve hetimore parlamentare dhe me pozitën e rolin kushtetues të organit të Prokurorisë, vlerëson se veprimtaria e Komisionit Hetimor në këtë rast, në tre drejtime nga ato të përmendura më sipër, përbën tejkalim të funksioneve të Kuvendit, mosrespektim të parimeve kushtetuese, si dhe ndërhyrje në kompetencat e organit të Prokurorisë. Kjo për arsye, se çështjet objekt hetimi parlamentar, sipas Kushtetutës dhe legjislacionit përkatës, i takojnë për

kontroll e zgjidhje këtij organi dhe jo organeve të tjera, përfshirë dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor është kontrolli mbi vendimet e mosfillimit të çështjeve penale, të pushimit të hetimeve apo pezullimit të tyre. Kështu, komisioni ka marrë përsipër të kontrollojë dhe të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe rregullshmërinë e këtyre vendimeve. Gjykata është shprehur me vendimin nr.26/2006, se në aspektin funksional këto janë kompetenca të organit të prokurorisë dhe që nuk i përket veprimtarisë kontrolluese të legjislativit. Prokurori më i lartë është autoriteti që ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët (neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale). Ky parim i rëndësishëm i organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë, si organ i centralizuar, që i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjit (neni 148/3 i Kushtetutës), do të thotë se kontrolli i bazueshmërisë në ligj të vendimeve të prokurorëve dhe vlerësimi i shfuqizimi i tyre, është atribut i vetë prokurorisë ose organeve të caktuara me ligj, siç është gjykata (shih vendimin nr.26/2006). Lidhur me vendimet e mosfillimit të çështjeve penale, subjektet që kanë bërë kallëzimin kanë të drejtë ta ankojnë këtë vendim në gjykatë (neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale). Edhe ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale bëhet në gjykatë (neni 329 i Kodit të Procedurës Penale), ndërsa hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendim të prokurorit (neni 326/3 i Kodit të Procedurës Penale). Jashtë kontrollit të Kuvendit, nisur nga këto kriterë juridike, janë edhe çështje të tjera të përfshira në objektin e hetimit të komisionit, si kontrolli i plotësisë së kallëzimeve të bëra në prokurori, kontrolli i plotësisë së hetimeve të zhvilluara nga organi i prokurorisë, vlerësimi i cilësimeve juridike të bëra nga ky organ dhe i llojit e masës së dënimeve të kërkuara nga prokurori etj.

Në interpretim të nenit 77 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka theksuar, se hetimi parlamentar nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar. Ky kufizim imponon, që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, që hetimi parlamentar të lidhet me veprimtarinë e ligjvënësit dhe që hetimi të mos përdoret në mënyrë abuzive.

9. Sa më sipër, duke përfshirë në objektin e hetimit një numër çështjesh që nuk përfshihen në sferën kontrolluese të tij, organi ligjvënës ka cenuar kompetencat e organit të Prokurorisë dhe për rrjedhojë, ka krijuar një mosmarrëveshje kompetencash, që në kuptim të nenit 131 shkronja “ç” të Kushtetutës i përket për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese. Kjo Gjykatë, për këto arsye e konsideron konfliktin e kompetencave rrjedhojë të ndërhyrjes së pushtetit legjislativ (nëpërmjet komisionit hetimor) ndaj kompetencave kushtetuese e ligjore të organit të Prokurorisë në këto elemente ose gjetje të komisionit hetimor lidhur me Prokurorin e Përgjithshëm: a) në trajtimin e papërgjegjshëm të kallëzimeve penale të depozituara; b) në trajtimin e papërgjegjshëm të çështjeve të pushuara nga gjykata për mungesë provash; c) në trajtimin e papërgjegjshëm të rasteve flagrante të korrupsionit, të kallëzuara nga institucionet e tjera publike.

V

Lidhur me pretendimet se konkluzionet e komisionit hetimor nuk janë të bazuara, se Komisioni Hetimor nuk është ngritur duke respektuar kuorumin e përcaktuar nga Kushtetuta, dhe se Komisioni Hetimor ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, Gjykata vëren se këto çështje nuk kanë lidhje me mosmarrëveshjen e kompetencës, objekt i këtij gjykimi kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata e çmon jo të nevojshme analizën e hollësishme të këtyre pretendimeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “ç” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës të lindur midis dy organeve shtetërore, subjekt në këtë mosmarrëveshje dhe të deklarojë se Kuvendi i Shqipërisë nuk ka kompetencë të kontrollojë dhe të vlerësojë vendimet e prokurorëve në çështjet konkrete për mosfillimin e procedimit penal, për pezullimin e hetimeve, për pushimin e çështjeve penale, për marrjen e masave të sigurimit, si dhe të vendimeve e veprimeve të tjera të prokurorëve që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Kristofor Peçi.

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. Objekti i kërkesës së ish-Prokurorit të Përgjithshëm është “zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Prokurorisë të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa, në thelbin e saj, mbështetet në nenet 131/ç dhe 134/g të Kushtetutës. Në vështrim dhe të nenit 31 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” mendoj se kërkesa e ish-Prokurorit të Përgjithshëm duhej refuzuar si për mungesë kompetence të Gjykatës Kushtetuese, ashtu dhe për mungesë legjitimitimi të subjektit që ka paraqitur kërkesën. Sipas nenit 131/ç të Kushtetutës (citoj tekstualisht): “Gjykata Kushtetuese vendos për: ...mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore”. Çështja e parë që duhej të merrte në konsideratë shumica ishte pozicioni i Prokurorisë në raport me pushtetet e tjera. Sipas nenit 7 të Kushtetutës “sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet **pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor**”. Duke i qëndruar konsekuente vendimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese shumica arsyeton se “dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej këtyre pushteteve. Konfirmimi nga ana e shumicës i një qëndrimi të mbajtur më parë nga kjo gjykatë, nuk i ka dhënë mundësi kësaj gjykate të ndreqë një qëndrim të gabuar të mbajtur më parë, kur duke mos i qëndruar korrekt gërmës së Kushtetutës, ka bërë një interpretim të zgjeruar të saj pa pasur një kërkesë, në kuptim dhe të nenit 71 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata Kushtetuese në vendimet e mëparshme (nr.26/2006, nr.29/2006 dhe nr.20/2007) ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 48 të ligjit të saj organik, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese nuk mund të dalë jashtë kufijve të objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të.

Duke iu kthyer thelbit të problemit, Prokuroria në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është konceptuar si një organ i centralizuar dhe i pavarur. Prokuroria shqiptare nuk është pjesë as e pushtetit gjyqësor, por nuk është gjithashtu pjesë as e pushtetit ekzekutiv. Ajo është një institucion kushtetues i pavarur siç janë edhe të tjerë, si p.sh Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit etj. Edhe në Kushtetutat e vendeve të tjera demokratike, për çështjen në shqyrtim, ka qëndrime dhe zgjidhje të ndryshme për konfliktet e pushtetit, diku flitet për konflikte të pushteteve dhe i referohen ekskluzivisht tre pushteteve që përmend edhe Kushtetuta jonë, diku tjetër flitet për konflikte midis organeve të pushtetit, diku midis organeve të qeverisjes, Kushtetuta të tjera nuk e njohin konfliktin e kompetencave midis pushteteve ose organeve të pushtetit, madje e konsiderojnë një gjë të tillë si një çështje të natyrës politike dhe zgjidhja e tyre duhet të jetë e natyrës politike (Austria) etj. Modeli shqiptar, duke i qëndruar korrekt formulimit kushtetues, i jep kompetencë Gjykatës Kushtetuese që ta zgjidhë konfliktin e kompetencave vetëm midis pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, me fjalë të tjera midis Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe gjykatave, të cilat janë të vetmet që përfaqësojnë pushtetin gjyqësor (shih nenin 135 të Kushtetutës).

Kërkesa duhej refuzuar edhe për një shkak tjetër kushtetues. Duke mos gjetur hapësirë për legjitimitimin e kërkesës së tij (sepse Prokuroria e Përgjithshme nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës), në mënyrë spekulative Prokurori i Përgjithshëm e mbështet kërkesën e tij në gërmën “g” të nenit 134 të Kushtetutës, si kërkesë individuale, si një çështje që ka cenuar interesat e tij individuale, kur individët, sipas Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese mund t’i drejtohen kësaj gjykate vetëm për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave (germa f e nenit 131 të Kushtetutës). Këto ishin arsyet për të cilat kërkesa e ish-Prokurorit të Përgjithshëm duhej refuzuar pa u marrë fare në shqyrtim.

2. Edhe në qoftë se do ta konsiderojmë të mirëqenë vendimin e shumicës, pra duke anashkaluar çështjet e mësipërme, trajtimi që i bëhet konfliktit të kompetencave është i gabuar. Kërkuesi duhej të paraqiste argumente se moszgjidhja ose ekzistenca e konfliktit të kompetencave me Kuvendin ka sjellë ose mund të sillte pengimin e funksionimit normal të veprimtarisë së Prokurorisë, ka cenuar statusin e këtij organi dhe rrjedhimisht ushtrimin e kompetencave dhe të drejtave të njohura me Kushtetutë dhe ligje të tjera. Sipas doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese do të jemi para një konflikti kompetencash, në rast se ushtrimi i kompetencave nga njëri (Prokuroria) apo tjetri organ (Kuvendi) është i diskutueshëm, me fjalë të tjera kur dy organe të ndryshme pretendojnë ushtrimin e së njëjtës kompetencë. Veprimtaria e komisionit hetimor të Kuvendit dhe vendimi i marrë prej këtij të fundit nuk ka cenuar aspak të drejtën e Prokurorisë

për të filluar lirisht çështje penale, për t'i pushuar apo pezulluar ato apo për dërgimin ose jo në gjyq të çështjeve konkrete. Kuvendi nuk ka pretenduar dhe as ka tentuar të marrë ndonjë nga kompetencat e përmendura më lart, apo të ndërhyjë në kompetencat e prokurorit apo gjykatës për miratimin apo shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurorët. Jo vetëm kaq, por konkluzionet e Kuvendit mbështeten jo në shqyrtimin e vendimeve të prokurorëve në çështje konkrete, siç shprehet shumica në dispozitivin e vendimit, por në materiale të dërguara nga organet që kanë të drejtë të inspektojnë sipas ligjit veprimtarinë e Prokurorisë (Ministria e Drejtësisë, shih nenin 56 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”) apo organe që për shkak të detyrave të përbashkëta në luftën kundër kriminalitetit kanë raporte ndërinstitucionale midis tyre (Ministria e Brendshme). Në raportin e komisionit hetimor, miratuar nga Kuvendi ka argumente të mjaftueshme që tregojnë respektin e këtij organi edhe për vendimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, duke ndryshuar në mënyrë thelbësore objekti i veprimtarisë së tij nga praktikatat e mëparshme. Në këtë raport jo vetëm që nuk ka trajtim të vendimeve të marra nga prokurorët për çështje konkrete siç thuhet në dispozitivin e vendimit, por në të gjejmë vend edhe çështje të tjera që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë vendimmarrëse procedurale, të tilla si qëndrimet e mbajtura nga Prokuroria për ekstradimet apo për arrestet ndërkombëtare etj. Në këto rrethana, edhe në thelb, vendimi i shumicës është i gabuar dhe nuk mbështetet në argumentet lidhur me rrethanat konkrete të çështjeve objekt hetimi të komisionit hetimor të Kuvendit, por është thjesht konfirmim i qëndrimeve të mbajtura nga kjo gjykatë në vendimet e mëparshme të përmendura më lart.

3. Së fundi, Kuvendi i Shqipërisë, duke pasur të drejtën t'i propozojë Presidentit të Republikës shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij (neni 149 i Kushtetutës), në mënyrë të natyrshme dhe të ligjshme ka të drejtën të kontrollojë në çdo kohë veprimtarinë e tij me qëllim që ajo të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të këtij organi të rëndësishëm që vepron në emër të shtetit në një fushë shumë të rëndësishme të veprimtarisë së tij siç është ajo e luftës kundër krimit.

Kryetari: Vladimir Kristo

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 21 maj 2008, në udhëzimin e MPPTT nr.5, datë 29.4.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, në tabelën nr.3 bëhet kjo ndreqje:

Ishte:

3. Transporti i mallrave brenda vendit

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për llogari të vet	certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	certifikatë	bashkia/komuna
Transporti me mjete jashtë norme	licencë	DPSHTRR

Bëhet:

3. Transporti i mallrave brenda vendit

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	licencë	Bashkia/qarku, për komunat

Transporti për llogari të vet	certifikatë	Bashkia/komuna
Transporti i mallrave të rrezikshme	certifikatë	DPSHTRR
Transporti me mjete jashtë norme	licencë	DPSHTRR

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.6.2008
Doli nga shtypi më 3.6.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë